



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme/Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost  
Kosovo Academy for Public Safety

Në bazë të nenit 80 dhe 81, të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/212 i Punës, Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Akademia e Kosovës për Siguri Publike shpall konkurs.

### Për plotësimin e vendit të punës

<b>Pozita:</b>	Mjek i praktikës së përgjithshme
<b>Nr. i references:</b>	AKSP-166
<b>Numri i vendeve të punës:</b>	1 (një)
<b>Paga bazë (koeficienti)</b>	H 10 -7.4
<b>Orari i punës:</b>	I plotë
<b>Periudha e kontratës</b>	Pa afat të caktuar (puna provuese 6 muaj)

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Divizioni për Shërbime të Përbashkëta.

**Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:** Nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësin e Udhëheqësit të Divizionit të Shërbimeve të Përbashkëta, është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve mjekësore për vijuesit e trajnimeve dhe arsimit të lartë në akademi, si dhe personave tjerë që marrin pjesë në punë dhe aktivitete që lidhen direkt me akademinë.

### Detyrat dhe përgjegjësit kryesore

- Ofrimi i shërbimeve mjekësore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;
- Përcaktimi i diagnozës dhe ofrimi i terapisë adekuate;
- Referimi i pacientëve për në QE & QKUK;
- Përkrahja në realizimin e trajnimeve përmes demonstrimit të ofrimit të ndihmës së parë;
- Realizimi i vizitave mjekësore në hapësirat ku zhvillohen aktivitete sportive dhe në hapësirat tjera të akademisë sipas kërkesave të palëve;
- Menaxhimi i punës në Sektorin Mjekësor dhe mbikëqyrja e teknikëve/infermierëve;

Adresa: Rr. Gjergj Kastrioti Skënderbeu - 42000 Vushtrri-Kosovë

Tel: 028 590 070, ext 210

Web: <http://www.aksp-ks.net/>

7. Përgatitja e raporteve javore, mujore dhe vjetore, dhe përcjellja e protokollit ditor mjekësor;
8. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm e që kërkohen kohë pas kohe nga Udhëheqësi i Divizionit të Shërbimeve të Përbashkëta.

#### **Kërkesat e përgjithshme për pranim;**

- Të jetë shtetas i republikës së Kosovës,
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji;
- Certifikata se ndaj tij/saj nuk zhvillohen hetime,
- Certifikata e lindjes .

#### **Shkollimi dhe përvoja e kërkuar**

- Përgatitje Universitare – Mjekësi e Përgjithshme (e obligueshme).
- Certifikata e licencimit (e obligueshme).
- Stazhi i punës sipas kërkesave të ligjit .

#### **Aftësia, dhe atributet tjera që kërkohen**

Njohuri të mira të punës me kompjuter, në programet Microsoft Word, Excel, Power Point. Fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion dhe brenda afateve të kufizuara kohore, aftësi për të punuar me njerëz të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, gjinisë dhe pikëpamjeve të ndryshme politike duke ruajtur paanshmërinë dhe objektivitetin, vet-iniciativë dhe përkushtim i vëmendjes ndaj detaleve dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor.

#### **Data e mbylljes së konkursit**

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, duke filluar nga data 19.10.2024 deri me datën 17.11.2024, në ora 16:00.

Vlerësimi i kandidatëve, bëhet duke respektuar legjislacionin në fuqi.

### **Paraqitja e kërkesave**

Aplikacionet dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike – Vushtrri, zyra e personelit numër 1. Aplikacionit i bashkëngjitet një cv profesionale dhe kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurrioni. Forma e aplikacionit mund të shkarkohet nga ueb faqja e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike: <http://www.aksp-ks.net/>.

***Akademia e Kosovës për Siguri Publike ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.***

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për informata me te hollësishme mund te kontaktoni Zyrën e Personelit nr. tel: 028 590 070 Ext 210 ose 211, prej orës 08:00 - 1600.